



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË



**Përmbledhje**  
**E Mbledhjes së Katërt të Komitetit Kombëtar të Sistemeve të Pagesave (KKSP)**

e cila u mbajt

të premten, datë 20 Qershor 2018, nga ora 14.00 deri 17.30 në ambientet  
e Tirana International Hotel

Në datën 20 qershor 2018, u zhvillua mbledhja e katërt e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP), e cila u hap dhe u drejtua nga Kryetarja e këtij Komiteti zj. Elisabeta Gjoni, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë.

Në fjalën e saj hyrëse zj. Gjoni theksoi rëndësinë e kësaj mbledhjeje, e cila do të shënojë themelet e një përpjekje të përbashkët për reformimin e sistemeve të pagesave në përgjithësi dhe atyre me vlerë të vogël në veçanti. Në vijim, zj. Gjoni theksoi hapat e ndërmarra në kuadër të zhvillimeve të sistemit të pagesave dhe për këtë qëllim, shkurtimisht prezantoi projektet e realizuara deri më tani nga KKSP dhe prioritetet e këtij komiteti në lidhje me *Strategjinë kombëtare për zhvillimin e pagesave me vlerë të vogël* duke dhënë një panoramë të përgjithshme mbi programin e mbledhjes së KKSP.

Mbledhja filloi me pikën e parë të rendit të ditës: **prezantimin e rishikimit të rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komitetit** Kombëtar të Sistemeve të Pagesave me qëllim zgjerimin e pjesëmarrësve bazuar në rekomandimet e ekspertëve të Bankës Botërore. Rishikimi synonte përfshirjen në KKSP edhe të përfaqësuesve nga institucione financiare jo-banka dhe përfaqësues nga operatorët e sistemeve të pagesave. Ky zgjerim kishte qëllim një pjesëmarrje sa më gjithëpërfshirëse të aktorëve të tregut në Komitet, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Në këtë kuadër zj. Gjoni **mirëpriti anëtarët e rinj, përfaqësues të këtyre institucioneve**, si dhe shprehu gjithashtu kënaqësinë e saj për përfshirjen në Komitet të zj. Senida Mesi, Zëvendëskryeministre e Republikës së Shqipërisë, në kuadër të digjitalizimit dhe inovacionit për shërbimet shtetërore, si dhe z. Silvio Pedrazzi, Kryetarin e ri të Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Në vijim të pikës së dytë të rendit të ditës u ftua përfaqësuesja e Bankës Botërore, zj. Maria Do Ceu Da Silva Pereira për **prezantimin e analizës së tregut të remitançave** me qëllim identifikimin e nevojave për ndërhyrje, të cilat janë adresuar në planin e veprimit të strategjisë. Zhvillimet kryesore në këtë drejtim lidhen me përmirësimet ligjore e rregullative, si dhe zhvillimeve infrastrukturore. Zj. Gjoni nënvizoi se Banka e Shqipërisë po i kushton vëmendje të veçantë tregut të remitançave dhe për këtë qëllim ka nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Gjithashtu, ajo përmendi se Banka e Shqipërisë me qëllim thellimin e njohurive mbi këtë treg ka botuar dhe një revistë<sup>1</sup> me titull *Remitanca, një mbështetje për zhvillim* dhe ftoi pjesëmarrësit të njiheshin me këtë botim. Në përfundim të prezantimit, kryetarja e KKSP ftoi anëtarët të miratonin publikimin e këtij materiali, të cilët **shprehën dakordësinë e tyre**.

<sup>1</sup>[https://www.bankofalbania.org/Botime/Remitanca\\_Nje\\_mbeshetje\\_per\\_zhvillim.html](https://www.bankofalbania.org/Botime/Remitanca_Nje_mbeshetje_per_zhvillim.html)

Mbledhja vijoi me pikën e tretë të rendit të ditës, prezantimin nga përfaqësuesi i Bankës Botërore, z. Jose Antonio Garcia, i cili bëri një **përmbledhje të gjetjeve të analizës së tregut shqiptar nga pikëpamja e përfshirjes financiare**. Në këtë prezantim u identifikua qartazi nevoja e rritjes së popullsisë e cila zotëron një llogari bankare, nga rreth 40% që është aktualisht në 70% deri në vitin 2022, si dhe nxitjen e përdorimit të këtyre llogarive. Për më shumë, eksperti i Bankës Botërore nënvizoi se gjetjet e kësaj analize janë bazat kryesore për strategjinë kombëtare për reformimin e sistemeve të pagesave me vlerë të vogël. Në të njëjtën linjë me materialin e mëparshëm, zj. Gjoni mori **dakordësinë e anëtarëve për miratimin e dokumentit dhe publikimin e tij**.

Sipas programit të mbledhjes, u vijua me **prezantimin e rezultateve të studimit mbi matjen e kostove të instrumenteve të pagesave** nga z. Holti Banka. Përtej identifikimit të kostove të larta që mbart përdorimi i *cash*-it në ekonomin shqiptare, në prezantim u identifikuan dhe kostot e përballuara nga secili aktor ekonomik, ku interes të veçantë paraqesin kostot për ofruesit e shërbimeve të pagesave (*banka dhe jo banka*). Për më shumë, z. Banka prezantoi dhe disa skenarë, të cilët identifikonin kursimet që mund të përfitohen në nivel ekonomie nga zëvendësimi i *cash*-it me instrumente të caktuar elektronikë. Gjithashtu, z. Banka identifikoi dhe fusha ku këto ndërhyrje mund të materializohen me sukses. Me marrjen e **dakordësisë nga anëtarët e KKSP mbi rezultatet dhe konkluzionet e këtij punimi, si dhe publikimin e tij, u miratua në tërësinë e saj paketa e analizave dhe studimeve mbi të cilat ishte bazuar hartimi i strategjisë kombëtare për pagesat e me vlerë të vogël në Shqipëri**.

Mbledhja vijoi me pikën e pastë të rendit të ditës: **prezantimin e strategjisë kombëtare për pagesat me vlerë të vogël në Shqipëri** nga z. Garcia, ku vëmendje e veçantë iu kushtua vizionit të krijuar dhe masave për arritjen e këtij vizioni nëpërmjet një plani veprimi të detajuar, ku janë identifikuar hapat që duhen ndërmarrë nga secili aktor. Në këtë seksion diskutimet e anëtarëve u fokusuan në sugjerimet dhe komentet në lidhje me zbatimin sa më efikas të strategjisë.

*Diskutime në lidhje me strategjinë e prezantuar dhe të njohur paraprakisht nga anëtarët e KKSP:*

- Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave Z. Pedrazzi. theksoi se ndihet veçanërisht i kënaqur për nismat e sipërcituara dhe krijimin e një vizioni të përbashkët strategjik për të gjithë aktorët. Z. Pedrazzi theksoi se *cash* mund të jetë një zgjedhje e natyrshme e publikut shqiptar, ashtu si ndodh edhe në tregje më të zhvilluar, por objektivi i përbashkët duhet të jetë ofrimi i sa më shumë alternativave efikase me qëllim përfshirjen financiare dhe përdorimin e tyre nëpërmjet instrumenteve elektronike. Në këtë drejtim, z. Pedrazzi theksoi e bankat kanë qenë promotor në nxitjen e përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike dhe investime të konsiderueshme janë ndërmarrë në këtë drejtim. Për më shumë, Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave nënvizoi se bankat kanë ndërmarrë hapa për ofrimin e llogarive dhe shërbimeve me kosto të ulta për shtresa të ndryshme të popullsisë. Për më shumë, z. Pedrazzi, theksoi dhe rolin aktiv të bankave në edukimin financiar. Z. Pedrazzi theks të veçantë i vuri nevojës për promovim të inovacionit dhe krijimit të kushteve konkurruese në mënyrë të barabartë për të gjithë aktorët. Në këtë drejtim z. Pedrazzi theksoi nevojën e krijimit të një ambienti të përshtatshëm rregullativ për promovimin e shërbimit e në distancë dhe eliminimin e nevojave për prezencë fizike. Në përfundim të fjalës së tij Kryetari SHSHB theksoi se administrimi i rreziqeve, krijimi i procedurave efikase mbi qeverisjen efikase të institucioneve si dhe kriteret për adresimin parandalimit të pastrimit të parave janë komponent kyç për bankat, mbase ka vend për lehtësimin e rritjen e efikasitetit të këtyre procedurave që mos behën pengese në vijimësinë e veprimtarisë. Z. Pedrazzi theksoi krijimin e kushteve të barabarta edhe për aktorët e tjerë të cilët synojnë të hyjnë në tregun e pagesave me vlerë të vogël dhe në projekt strategjinë të mos adresohemi vetëm në emra operatoresh konkretë por të jetë e hapur.
- Në këtë kuadër zj. Gjoni ndërhyri duke nënvizuar se Banka e Shqipërisë i ka kushtuar dhe do vijojë të kushtojë një vëmendje të veçantë konkurrencës dhe kushteve të barabarta në terma të barabarta dhe gjithëpërfshirëse dhe reflektimin e sugjerimeve në përmbajtjen e dokumentit të Strategjisë kombëtare për sistemet e pagesave me vlerë të vogël.

- Gjithashtu, Z. Deralla, Drejtor pranë Departamentit të Mbikëqyrjes, theksoi se Banka e Shqipërisë i ka kushtuar dhe do të vijoi t'ia kushtojë vëmendje të veçantë analizimit të kuadrit rregullativë me qëllim mundësimin e operimit *on-line* dhe pa prezencën fizike të klientëve si dhe eliminimin e barrierave për zbatimin e praktikave inovative në shërbimet bankare. Për më shumë, z. Deralla propozoi dhe zgjerimin e pjesëmarrjes në KKSP dhe të Shoqatën e institucioneve të mikrokredivë, të krijuar rishtazi, institucione këto që bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullativë mund të përfshihen dhe në fushën e shërbimeve të pagesave.
- Z. Çollaku, Drejtor i Përgjithshëm i Unionit Financiar, ndërhyri duke nënvizuar se nga pikëpamja e tregut të remitancave janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në kuadër të përfaqimit të inovacionit dhe reduktimit të kostove, megjithatë sfidat mbeten ende të mëdha dhe të tilla nisma do ndihmojnë në maksimizimin e efekteve në treg.
- Zj. Stela Shkodrani, përfaqësuese e Easypay nënvizoi rëndësinë e nismave të paraqitura në mbledhjen e KKSP për tregun shqiptar, si dhe zbatimin e këtyre nismave nëpërmjet materializimit të planit të veprimit të parashikuar në strategji. Në kuadër të zbatimit të strategjisë ndërhyri dhe zj. Eneida Thomaj, Drejtor i Përgjithshëm i Paylink, duke identifikuar gatishmërinë e operatorit për të bashkëpunuar me aktorët e tregut në çdo lloje forme të përshtatshme me qëllim zbatimin e masave të parashikuara në strategji për procesimin e pagesave me kartë brenda vendit.
- Së fundi, zj. Najada Xhaxha, Kryetare e Komitetit të Pagesave, pranë Shoqatës Shqiptare të Bankave, nënvizoi nevojën për ndërhyrje në kuadër të promovimit të efikasitetit të instrumenteve të pagesave duke theksuar dhe nevojën për ndërhyrje me qëllim përdorimin e skemave dhe platformave kombëtare në këtë drejtim.
- Në këtë drejtim zj. Gjoni, theksoi se nevoja e krijimit të platformave kombëtare është evidentuar nga Banka e Shqipërisë,. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë ka punuar për organizimin e një konference *Modernizimi i sistemeve të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri*, dhe konkluzionet e kësaj konference në lidhje me krijimin e këtyre platformave si *instant payment* dhe SHWITCH kombëtar do të reflektoheshin dhe në strategjinë e prezantuar në KKSP, ku së bashku me reflektimin e komenteve dhe sugjerimeve do të dërgohen për miratim final.

Mbledhja vijoi me prezantimin e zj. Anjeza Beja, Drejtor pranë Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës pranë Bankës së Shqipërisë mbi nxitjen e përfshirjes financiare dhe propozimin e dy zgjidhjeve konkrete, si: (1) llogaria *obazikeo* për kategori të caktuara të popullsisë, dhe (2) prezantimi i bankave të cilat operojnë edhe nëpërmjet agjentëve.

Programi i mbledhjes u finalizua me prezantimin e direktivës evropiane *DPër shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm 20* nga zj. Maria Do Ceu Da Silva Pereira, e cila u fokusua kryesisht në trajtimin e risive dhe sfidave që burojnë nga transpozimi i kësaj direktive në legjislacionin shqiptar. **Vlen të theksohet se me miratimin e ligjit *DPër shërbimet e pagesave në Republikën e Shqipërisë* realizohet njëkohësisht edhe zbatimi i një numri të konsiderueshëm të planeve të veprimit të parashikuara në strategjinë kombëtare** të sistemeve të pagesave me vlerë të vogël, të tilla si: mbrojtja e konsumatorit, promovimi i inovacionit në tregun e pagesave, nxitja e transparencës dhe zgjerimi i aksesit në sistemet e pagesave, etj.

Punimet e mbledhjes u mbyllën me propozimin e zj. Gjoni për krijimin e Grupeve të Punës me anëtarë nga Komiteti me qëllim zbatimin e objektivave dhe planeve të veprimit të parashikuara në strategjinë kombëtare të sistemeve të pagesave me vlerë të vogël.

### ***Rekomandimet e mbledhjes së katërt të Komitetit Kombëtarë të Sistemit të Pagesave.***

1. Krijimi dhe zbatimi i objektivave të parashikuara në strategji në lidhje me :
  - a) Task Force për monitorimin e zbatimit të strategjisë për *Strategjinë Kombëtare për reformimin e Sistemeve të Pagesave me Vlerë të Vogël në Shqipëri*.

- b) Grupin e punës për krijimin e infrastrukturave kombëtare në mbështetje të sigurisë dhe efikasitetit të instrumenteve të pagesave (si ato me kartë dhe transfertave të kreditit në formë elektronike) sipas parashikimeve të strategjisë.
- c) Grupin e Punës për krijimin e llogarisë bankare bazike (përfshirja financiare).
- d) Grupin e Punës për procesimin e pagesave në euro me vlerë të vogël brenda vendit.

Propozimi për mbledhjen e radhës: **Në muajin Dhjetor 2018**

<b>Anëtarët e KKSP në Mbledhjen e Katërt</b>			
<b>Institucioni</b>	<b>Emri i Anëtarit</b>	<b>Statusi në KKSP</b>	<b>Përfaqësuar në rast mungese</b>
Banka e Shqipërisë	Zj. Elisabeta Gjoni, Zëvendësguvernatore e Parë	Kryetare	
Kryeministria	Zj. Senida Mesi, Zëvendëskryeministre	Anëtar	-----
Shoqata Shqiptare e Bankave	Z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave	Anëtar	
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Z. Erjon Luçi Zëvendësministër	Anëtar	-----
Ministri i Shtetit për Diasporën	Z. Pandeli Majko, Ministër Shteti	Anëtar	-----
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Eksekutiv	Anëtar	Z. Niko Kotonika
Banka e Shqipërisë	Zj. Ledia Bregu, Drejtoresh e komanduar, DSPKF	Anëtar	
Banka e Shqipërisë	Z. Deniz Deralla, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes	Anëtar	
Banaku i Shqipërisë	Z. Donald Duraj, Shefi i Kabinetit	Anëtar	Zj. Erinda Nervaj
Shoqata Shqiptare e Bankave	Zj. Najada Xhaxha, Kryetare e Komitetit të Pagesave pranë SHSHB	Anëtar	
Shoqata Shqiptare e Bankave	Z. Spiro Brumbull Sekretar i Përgjithshëm	Anëtar	
Paylink	Zj. Eneida Thomaj, Drejtoresh e Përgjithshme	Anëtar	
Unioni Financiar	Z. Elton Çollaku, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	
Easy Pay	Zj. Linda Shomo Drejtoresh e Përgjithshme	Anëtar	Zj. Stela Shkodrani
MPay	Z. Ludovic Lavature, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Zj. Erinda Kapllani
AK-Invest	Z. Ilir Adili Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	
NOA	Zj. Herjola Spahiu	Anëtar	Zj. Komola Mecaj

	Drejtores e Përgjithshme		
Kastarti. SH.P.K	Z. Ramazan Hoda Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	-----
Pay and Go	Z. Otar Mgeladze Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	-----

<b>Pjesëmarrës të tjerë në mbledhjen e KKSP</b>			
<b>Të ftuar për prezantim/ Pjesëmarrje</b>	<b>Sekretariati</b>	<b>Shoqërues të anëtareve</b>	<b>Të ftuar</b>
Z. Jose Antonio Garcia, Sr. Payment Systems Advisor	Zj. Valentina Semi (BSH)	Zj. Flora Musta, AMF	Z. Indrit Xhemali, Drejtor, DTI, BSH
Zj. Maria Do Ceu Da Silva Pereira, Sr. Payment Systems Specialist		Zj. Keti Zotaj , M PAy	Z. Altin Naqe, Drejtor, DJ, BSH
Z. Holti Banka, Payment System Specialist		Zj. Suzana Adili, AKInvest	Zj. Rozeta Shkemi, Zv. Drejtor, DJ, BSH
Znj. Anjeza Beja , Drejtore i DSPKF		Zj. Odeta Ferro, AK- Invest	Z. Besjana Bufi, P/Spektori, DJ, BSH
		Zj. Irida Huta, Paylink	Z. Valer Miho, Zv. Drejtor, DSPKF, BSH
			Zj. Marsida Ganaj, P/Spektori, DSPKF, BSH
			Zj. Edlira Hoxha, DSPKF, BSH
			Zj. Armida Isakaj, DSPKF, BSH
			Zj. Jona Sota, DSPKF, BSH
			Zj. Amela Meço, DSPKF, BSH
			Zj. Ina Molla, P/Zyrës së Shtypit, KG, BSH